



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

OPINION

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio

R. nr. 275/2025

në lidhje me

procesin e korigjimit/uljes së koeficienteve të disa zyrtarëve publikë

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, kryeministër në detyrë
Qeveria e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 9 shtator 2026

Qëllimi

Avokati i Popullit, nëpërmjet këtij Opinioni, do të shprehë qëndrimin e përgjithshëm lidhur me procesin e uljes së koeficienteve të pagave të disa zyrtarëve publikë, pas caktimit fillestar të tyre me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (në vijim: Ligji për Paga), në dritën e garancive kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

1. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se për çështjen e theksuar më sipër ka pranuar disa ankesa, si dhe rrethanat e tilla prekin një numër relativisht të madh të zyrtarëve publikë, hapi rast sipas detyrës zyrtare, me qëllim të analizimit dhe hetimit të çështjes së korrigjimit/uljes së koeficienteve, pas caktimit fillestar të tyre me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga.
2. Lidhur me ankesat që pranuan nga ankuesit, Avokati i Popullit hapi rastet:
 - R. nr. 370/2024, për ankuesit L. K. dhe të tjerët,
 - R. nr. 456/2024, për ankuesit M. H. dhe të tjerët,
 - R. nr. 628/2024, për ankuesit D. K. dhe të tjerët,
 - R. nr. 1438/2024, për ankuesen M. M.,
 - R. nr. 22/2025, për ankuesit B. S. dhe të tjerët,
 - R. nr. 751/2025, për ankuesit S. S. dhe të tjerët.
3. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se, lidhur me çështjet e ngritura nëpërmjet ankesave, ankuesit janë duke shfrytëzuar mjetet juridike, përkatësisht janë në procedura gjyqësore, nuk do të lëshohet në vlerësimin meritore të çështjes së korrigjimit/uljes së koeficienteve, por do të japë vlerësimin e tij lidhur me aspektet që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e garantuara, siç janë: e drejta e pronës, siguria juridike si element i rëndësishëm i sundimit të ligjit, pritshmëria legjitime dhe respektimi i procedurave ligjore në çdo rast që prek, kufizon apo mohon të drejtat e garantuara me Kushtetutë ose me akte të tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Nëpërmjet këtij Opinioni do të vlerësohen veprimet për korrigjimin/uljen e koeficienteve të disa zyrtarëve publikë, pas caktimit fillestar të tyre me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për Paga.
5. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se nëpërmjet këtij Opinioni do të jepen vetëm qëndrime parimore, konsideron se ky Opinion mund të kontribuojë edhe në procedurat gjyqësore që janë duke u zhvilluar lidhur me këto çështje.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.” Kurse në paragrafin 3 përcakton: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”
7. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).

“Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).

“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).

“Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).

“Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).

“T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

“Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit.” (Neni 16, paragrafi 9).

8. Me dërgimin e këtij Opinioni tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të sipërshënuara.

Përshkrimi i çështjes

9. Avokati i Popullit vërejti se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP), i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, në koordinim me disa institucione, punonjësit e të cilave kanë parashtruar ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit, u ka korrigjuar/ulur koeficientet e pagës disa zyrtarëve publikë, të cilëve, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga, u ishte caktuar koeficienti fillestar. Avokati i Popullit vërejti se, përveç procesit të korrigjimit/uljes së koeficienteve, zyrtarët në fjalë u detyruan që, në mënyrë retroaktive, ta kthenin diferencën e pagës, përkatësisht diferencën ndërmjet koeficientit të ulur dhe koeficientit fillestar, për periudhën gjatë së cilës kishte qenë në fuqi koeficienti fillestar.
10. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga disa punonjës të institucioneve në Republikën e Kosovës, të cilët pretendojnë se të drejtat e tyre janë cenuar fillimisht nga ndryshimi i koeficienteve dhe, për më tepër, se detyrimi për kthimin retroaktiv të diferencës ndërmjet koeficientit të ulur dhe koeficientit fillestar ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me dispozita të tjera të legjislacionit në fuqi.
11. Më tej, ankuesit pretendojnë se nuk janë njoftuar fare për uljen e koeficienteve dhe se nuk u është dhënë asnjë akt administrativ me të cilin do të njoftoheshin për ndryshimin e koeficienteve dhe efektet që rrjedhin nga këto ndryshime. Sipas tyre, deri në momentin e marrjes së pagave, ata nuk kanë qenë në dijeni se cili do të ishte efekti i ndryshimit të koeficienteve të tyre. Ata pretendojnë gjithashtu se asnjëherë nuk u është dorëzuar ndonjë akt

administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, por se për ndryshimin e pagave janë njoftuar vetëm gojarisht, pas interesimit të tyre lidhur me arsyet e këtij ndryshimi.

12. Përkitazi me rastet e hapura si rezultat i ankesave të ankuesve, Avokati i Popullit vërejt:

Ankesa R. nr. 370/2024:

- Ankuesit janë punonjës të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës, të cilëve, pas caktimit fillestar të koeficientit, u është ulur koeficienti dhe u është kërkuar që, në mënyrë retroaktive, ta kthejnë diferencën ndërmjet koeficientit fillestar dhe koeficientit të korrigjuar/ulur. Ankuesit pretendojnë se ky veprim është ndërmarrë pa i njoftuar ata dhe në mungesë të transparencës, si dhe se nuk e kanë të qartë se për cilat arsye u është ulur koeficienti.

Ankesa R. nr. 456/2024:

- Ankuesit janë punonjës të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës, të cilëve, pas caktimit fillestar të koeficientit, u është ulur koeficienti dhe u është kërkuar që, në mënyrë retroaktive, të kthejnë diferencën ndërmjet koeficientit fillestar dhe koeficientit të korrigjuar/ulur. Ankuesit pretendojnë se procedura e uljes së koeficienteve është zhvilluar në mungesë të transparencës dhe se nuk është e qartë se në bazë të cilave rrethana dhe dispozita DMZP-ja dhe ASHNA kanë vendosur për uljen e koeficienteve të tyre.

Ankesa R. nr. 628/2024:

- Ankuesit janë punonjës të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Ata kanë pohuar se, pas caktimit fillestar, koeficienti i tyre është ulur dhe se, përveç uljes së koeficientit, janë detyruar që në mënyrë retroaktive të kthejnë diferencën ndërmjet koeficientit fillestar dhe koeficientit të korrigjuar/ulur. Lidhur me këtë çështje, ankuesit pretendojnë se nuk janë njoftuar për uljen e koeficientit dhe se kjo ulje është bërë në mungesë të plotë të transparencës.

Ankesa R. nr. 1438/2024:

- Ankuesja punon si kryeinfermiere në QKMF në Gjilan. Ajo pohoi se, pas caktimit të koeficientit fillestar, koeficienti i saj është ulur dhe se është detyruar ta kthejë në mënyrë retroaktive diferencën ndërmjet koeficientit fillestar dhe koeficientit të korrigjuar/ulur. Ajo pretendon se për këtë ndryshim nuk është njoftuar paraprakisht dhe se procesi i uljes së koeficientit është zhvilluar në mungesë të plotë të transparencës.

Ankesa R. nr. 22/2025:

- Ankuesi dhe punonjësit e tjerë punojnë në Shtëpinë e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe në Shtëpinë e të Moshuarve në Komunën e Graçanicës. Ata pohojnë se, pas caktimit fillestar të koeficientit, koeficienti i tyre është ulur dhe se, përveç uljes së pagës, janë detyruar ta kthejnë në mënyrë retroaktive diferencën ndërmjet koeficientit fillestar dhe koeficientit të korrigjuar/ulur. Më tej, ankuesit pretendojnë se nuk kanë qenë në dijeni për këtë çështje dhe se, në rastin konkret, ka munguar transparenca.

Ankesa R. nr. 751/2025:

- Ankuesja dhe punonjëset e tjera janë të punësuar në Shtëpinë e Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore dhe me Aftësi të Kufizuara në Zhvillim Mendor, në kuadër të Komunes së Graçanicës. Ato pohojnë se koeficienti i tyre është ulur dhe se, përveç uljes së pagës, janë detyruar ta kthejnë diferencën ndërmjet koeficientit të ulur dhe koeficientit fillestar. Ato pretendojnë se për këtë nuk janë njoftuar paraprakisht, e as gjatë procesit të uljes së koeficientit, si dhe, në rastin konkret, nuk ka pasur transparencë dhe as proces të rregullt.
13. Lidhur me këtë çështje, ankuesit pretendojnë se DMZP-ja, me korrigjimin/uljen e koeficienteve të tyre, u ka cenuar të drejtat kushtetuese dhe ligjore të garantuara në Republikën e Kosovës, përkatësisht të drejtën e pronës, të drejtën për informim të drejtë në procedurë, si dhe të drejta të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
14. Avokati i Popullit analizoi të gjitha ankesat e ankuesve dhe vërejti se, në të gjitha rastet, asnjërit prej punonjësve të cilëve u është korrigjuar/ulur koeficienti nuk u është lëshuar një akt administrativ me të cilin do të njoftoheshin për ndryshimin e koeficientit dhe efektet që rrjedhin nga ky ndryshim, si dhe me të cilin do të udhëzoheshin për shfrytëzimin e mjeteve juridike në rast të pakënaqësisë me aktin në fjalë.

Analiza ligjore

15. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit analizoi Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe vërejti se ky ligj hyri në fuqi më 5 shkurt 2023. Që nga ajo kohë, zyrtarët publikë janë klasifikuar sipas shtojcave të këtij ligji dhe pagesat e tyre janë realizuar sipas koeficienteve të përcaktuar në këto shtojca.
16. Më tej, Avokati i Popullit vërejti se Qeveria e Republikës së Kosovës, më 16 shkurt 2023, nxori Vendimin nr. 04/128, me të cilin:
- Në pikën 1 të dispozitivit përcaktoi:

“Miratohet ekuivalenca e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficientëve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë për të punësuarit në sektorin publik, sipas Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik për të cilët është i nevojshëm procesi i klasifikimit të vendeve të punës.”
 - Në pikën 3 të vendimit përcaktoi:

“Obligohen Thesari i Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme që në vazhdimësi, dhe pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi t’i korrigjojnë/përshtatin të dhënat e të punësuarve në sektorin publik sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi ex officio dhe sipas kërkesës së Institucioneve.”
 - Në pikën 4 të vendimit përcaktoi:

“Nëse gjatë procesit të ekuivalencës dhe/apo korrigjimit si në pikën 3 të këtij vendimi shfaqet ndonjë mospërputhje në mes të sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficientëve, do të bëhet kompensimi respektiv për të gjitha rastet që korrigjohen.”
 - Në pikën 6 të vendimit përcaktoi:

“Obligohen të gjitha institucionet që deri më 30 shtator 2023 të përfundoj klasifikimin e vendeve të punës në institucionet e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

17. Avokati i Popullit analizoi Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe vërejti se neni 8 [Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme] përcakton:

“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave.

2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.”

18. Më tej, Avokati i Popullit analizoi nenin 9 [Parimi i administratës së hapur] dhe vërejti:

“1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.

2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.”

19. Avokati i Popullit vërejti se neni 53 [Procedura dhe efektet e anulimit dhe shfuqizimit], paragrafi 2, përcakton: *“Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.”*

20. Lidhur me çështjen e anulimit të aktit të ligjshëm, Avokati i Popullit analizoi nenin 56 [Anulimi i një akti administrativ të ligjshëm] dhe vërejti se paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, përcakton:

“1. Një akt administrativ i ligjshëm mund të anulohet, vetëm nëse:

1.1. anulimi është i dobiprurës për të gjitha palët apo anulimin është i pjesshëm dhe prek vetëm atë pjesë të aktit që nuk është dobiprurës për palën, [...].”

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

21. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, konsideron se Republika e Kosovë ka krijuar bazë të mjaftueshme, e cila rregullon çështjet e pagës dhe efekteve të tjera që lidhen me pagën.

22. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se Ligji i Pagave ka krijuar bazë të mirë për rregullimin e pagave në Republikën e Kosovës duke e pasur parasysh edhe vlerësimin dhe konstatimin e Gjykatës Kushtetuese të shprehur në Aktgjykimin KO 79/23.

23. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh ankesat e pranuar dhe pretendimet ankimore, thekson se në ato raste, institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, e që në rastin konkret kanë qenë të obliguara t’i zbatonin.

24. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit thekson se procedurat e tilla duhet të zbatohen krejtësisht në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje administrative.

25. Avokati i Popullit fillimisht thekson se është e paqartë baza ligjore e nxjerrjes së Vendimit nr. 04/128 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kur i referohet koeficienteve në shtojcat e Ligjit për Paga, por nuk autorizohet nga Ligji për Paga.

26. Për më tepër, Avokati i Popullit shfaq shqetësimin e tij veçanërisht te pika 4, sipas së cilës, në të gjitha rastet që korrigjohen, do të ketë kompensim përkatës. Në këtë rast, Avokati i Popullit thekson se një përcaktim i tillë është i paqartë, sepse nuk nënkupton nëse do ketë kthim të të hollave në rastet e zvogëlimit të koeficienteve, apo vetëm do ketë kompensim kur

është ngritur koeficienti. Sidoqoftë, në praktikë kjo pikë është përdorur edhe për kthimin retroaktiv të diferencës së korrigjimit të koeficienteve të zyrtarëve publikë përmes zvogëlimit të pagës dhe me këtë ua ka cenuar pronën e tyre.

27. Avokati i Popullit konsideron se paga e përfituar nga zyrtarët publikë nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat deri në momentin e ndryshimit të koeficientit përkatës përbën pronë të tyre. Rrjedhimisht, detyrimi për kthimin e diferencës së pagës, pa një vendim të organit kompetent, përbën cenim të së drejtës së tyre në pronë.
28. Avokati i Popullit thekson se në Kushtetutën e Republikës së Kosovës përcaktohet: *“Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”* (neni 21, paragrafët 2 dhe 3). Për më tepër, sipas Kushtetutës: *“E drejta e pronës garantohej.”* (neni 46, paragrafi 1).
29. Lidhur me procedurën e zhvilluar në çështjet e ndryshimit të koeficienteve, Avokati i Popullit vlerëson se procedura në fjalë nuk është zhvilluar sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
30. Këtë vlerësim Avokati i Popullit e bazon në faktin se, në asnjërin nga rastet në të cilat Avokati i Popullit ka pranuar ankesa, nuk është konstatuar se DMZP-ja apo punëdhënësi i ka njoftuar paraprakisht punonjësit për zhvillimin e procedurës për ndryshimin e koeficienteve dhe për efektet që do të rridhnin nga këto ndryshime. Po ashtu, pas përfundimit të procedurës, punonjësit nuk u janë lëshuar akte administrative me të cilat do të njoftoheshin për ndryshimin e pagave të tyre, efektet që do të rridhnin nga këto ndryshime, si dhe për mundësinë e përdorimit të mjeteve juridike në dispozicion.
31. Avokati i Popullit konsideron se veprimet administrative të institucioneve duhet t’i respektojnë parimet e sigurisë juridike dhe të pritshmërisë legjitime të personave ndaj të cilëve zhvillohet procedura administrative. Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se personat, përveçse duhet të njoftohen për zhvillimin e procedurës dhe rezultatet e saj, duhet të kenë mundësi t’i shfrytëzojnë mjetet juridike në dispozicion në rast të pakënaqësisë me veprimet e ndërmarra administrative.
32. Avokati i Popullit thekson se, në rastet kur aktet administrative kanë efekt retroaktiv, është veçanërisht e rëndësishme që procedura për nxjerrjen e tyre të bazohet në mënyrë të plotë në dispozitat ligjore që rregullojnë çështjen përkatëse. Në këtë mënyrë, veprimet e organeve të administratës do të konsiderohen të ligjshme, efektet e krijuara do të jenë të përcaktuara me ligj, ndërsa do të ruhet standardi i sigurisë juridike dhe i pritshmërisë legjitime të palëve.
33. Avokati i Popullit thekson se, në rrethanat e theksuara më sipër, nuk është konstatuar se institucionet i kanë zhvilluar procedurat në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të cilat kanë qenë të detyruara t’i respektojnë.
34. Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se është me rëndësi jetike që organet e administratës ta zbatojnë parimin e vlerave të përcaktuara në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit përcaktohet: *“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit [...]”* Gjithashtu, Avokati i Popullit konsideron se mosrespektimi i parimit të sundimit të ligjit ndikon drejtpërdrejt në cenimin e parimit të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, të përcaktuara me Kushtetutë.

35. Prandaj, Avokati i Popullit thekson se është obligim i të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës që ushtrojnë autorizime publike t’i zbatojnë në mënyrë të saktë dispozitat ligjore në situatat konkrete, pasi vetëm në këtë mënyrë sigurohet respektimi i parimit të sundimit të ligjit, si dhe i përcaktimeve ligjore që garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut.

Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme i dhe sigurisë juridike

36. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, thekson se në nenin 8 [Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme] përcaktohet: *“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.”*
37. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson se koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNj-së (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, *Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004*, § 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.)*, nr. 39794/98, § 73, *GJEDNJ 2002-VII*), “pritshmëria legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime reflektohet në faktin se për veprimet administrative rreth ndryshimit të koeficienteve duhet të zhvillohet procedurë administrative e për të cilën duhet të veprohet sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe sipas rrethanave të përcaktuara në këtë ligj. Veprimi pa u bazuar në dispozita ligjore dhe duke mos pasur parasysh kriteret e përcaktuara ligjore bien ndesh me konceptin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe me konceptin e sigurisë juridike.
38. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se pritshmëria e ligjshme dhe e arsyeshme është e pandashme nga koncepti i sigurisë juridike dhe se këto dy koncepte nuk mund të interpretohen të ndara nga njëra-tjetra. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se, në rastin konkret, koncepti i sigurisë juridike nënkupton detyrimin e institucionit për të ndërmarrë veprimet konkrete në bazë të dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të qartë çështjen në fjalë.
39. Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, si dhe konceptin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe të sigurisë juridike, Avokati i Popullit vlerëson se, për ndërmarrjen e veprimeve të tilla, institucionet janë të detyruara t’i zbatojnë dispozitat e ligjeve përkatëse dhe të veprojnë vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara me legjislacionin që rregullon fushën konkrete. Në rastin konkret, institucionet do të duhej t’i zbatonin dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të vepronin në përputhje me rrethanat dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Përfundim

40. Në bazë të rrethanave të theksuara më sipër, Avokati i Popullit vlerëson se procesi i ndryshimit të koeficienteve përbën proces administrativ, i cili duhet të zhvillohet në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
41. Avokati i Popullit konsideron se koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe i sigurisë juridike u mundëson subjekteve që veprimet e tyre t’i bazojnë në përcaktimet ligjore dhe në rrethanat e përcaktuara me dispozitat ligjore, si dhe t’i realizojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga këto dispozita.

41. Avokati i Popullit konsideron se koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe i sigurisë juridike u mundëson subjekteve që veprimet e tyre t'i bazojnë në përcaktimet ligjore dhe në rrethanat e përcaktuara me dispozitat ligjore, si dhe t'i realizojnë të drejtat e tyre që rrjedhin nga këto dispozita.
42. Avokati i Popullit thekson se veprimet administrative me efekt retroaktiv duhet të bazohen qartësisht në dispozita ligjore, ndërsa në rastin konkret nuk është e qartë nëse organet e administratës, gjatë korrigjimit/uljes së koeficienteve të zyrtarëve publikë, kanë pasur parasysh dhe kanë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
43. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit nuk ka arritur të konstatojë nëse efekti retroaktiv i ndryshimit të koeficienteve të zyrtarëve publikë është realizuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të cilat rregullojnë çështjen e anulimit të akteve administrative me efekt retroaktiv.
44. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se zyrtarët publikë nuk duhet të ndihen të pasigurt se ndaj tyre do të ndërmerren masa që kanë për qëllim ndryshimin e koeficientit dhe pagës së tyre, pa u plotësuar paraprakisht kushtet dhe procedurat e përcaktuara me dispozitat ligjore. Në këtë mënyrë do të ruhej parimi i sigurisë juridike dhe i pritshmërisë legjitime, që nënkuptojnë se gjendja juridike e zyrtarëve publikë mund të ndryshohet vetëm në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara qartë me dispozita ligjore.
45. Përfundimisht, Avokati i Popullit konsideron se veprimet e tilla të DMZP-së dhe të institucioneve të tjera, punonjësit e të cilave kanë parashtruar ankesa në Institucionin e Avokatit të Popullit, duhet të jenë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, si dhe me konceptet e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe të sigurisë juridike.
46. Prandaj, Avokati i Popullit vlerëson se, në rastin konkret, detyrimi i punonjësve për ta kthyer në mënyrë retroaktive diferencën e pagës, si pasojë e ndryshimit të koeficientit të tyre, nuk duket se është në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, si dhe me konceptet e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe të sigurisë juridike. Po ashtu, një detyrim i tillë duket se ka rezultuar në cenimin e pronës së tyre.

Me nderime,



Naim Qelaj
Avokat i Popullit